

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7800
E enjte, 30 maj 2024
Çmimi 0.50 €

KFOR-i kërkon të mbahen
përgjegjës personat që
sulmuan në Zveçan



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRASNIQI: MUNDËSIA PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT ËSHTË SHTERUAR, I HABITUR QË PARTITË E TJERA OPOZITARE S'PATËN GATISHMËRI



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka bërë me dije të mërkurën se është ezauruar mundësia e shpërndarjes së Kuvendit. "Thirrja dhe propozimi i PDK-së për koordinim mes partive më të mëdha politike në vend, që ta shpërndajmë Kuvendin, nuk ka gjetur mbështetjen e nevojshme. Unë mund

të hamendësoj për arsyet e gatishmërisë deklarative të partisë në pushtet për të shkuar në zgjedhje të parakohshme, por vërtet jam i habitur nga mosgatishmëria e partive opozitare për ta bërë një gjë të tillë, sepse mosshkuarja në zgjedhje, efektivisht po ia zgjat mandatin pushtetit aktual", ka thënë Krasniqi në konferencën për medie

OPINION

ALI AJETI -
VIGJILENTI
LIRIDASHËS F. 6

(Në 35-vjetorin e
rënies heroike)

Shkruan: Basrie
MURATI-SAKIRI



AKTUALE



TRAJTIMI I LËNDËVE TË KORRUPSIONIT
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR,
GLPS: KOHËZGJATJA MESATARE
PËR ZGJIDHJEN E TYRE, 688 DITË F. 3

AHMETI: DO TA MBROJMË
LEGJITIMITETIN E VOTËS
SË SHOQIPTARËVE F. 2

EKONOMI



HOTI: BORDI I TRUSTIT PENSIONAL,
PA ANËTARIN NGA SINDIKATAT,
QEVERIA KURTI PO NËPËRKËMBË
TË DREJTAT SINDIKALE F. 8

KREU I ATK-së: KA RRIJTJE
TË BIZNESEVE QË REGJISTROHEN
PËR ÇËSHTJE TATIMORE NË VERI F. 8

RASTI I LIDERËVE
TË UÇK-SË, TRUPI
GJYKUES URDHËRON
ZPS-NË: NA JEPNI
PLANIN SE SI DO
T'I PARAQITNI
PROVAT DERI NË
PRILL TË 2025-s F. 7



OSMANI, E ASHPËR
ME KONJUCËN
DHE QEVERINË:
OFERTA PËR KIE-n
NDRYSHOI ZOTIMET
E LIDERËVE PËR
ASOCIACIONIN F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT

BALLKANI ZYRTARIZON LARGIMIN E
DYSHES KUÇ - THAQI: FALEMINDERIT
LEGJENDA F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rasti i liderëve të UÇK-së, trupi gjykues urdhëron ZPS-në: Na jepni planin se si do t'i paraqitni provat deri në prill të 2025-s

HAGË, 29 MAJ - Konferenca e kësaj jave dhe paralajmërimet për vonesën tej mase të gjykimit ndaj krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, ka mobilizuar edhe gjyqtarët e Gjykatës Speciale në Hagë.


Të mërkurën kryegjyqtari Charles Smith ka lëshuar disa urdhra lidhur me dëshmitarët, shpalesjen e provave, në mënyrë që gjykimi ndaj katërshes së UÇK-së të jetë i shpejtë.

Në mesin e urdhrave më të rëndësishëm, është ai ndaj Zyrës së Prokurorit të Specializuar që të ofrojë një plan me detaje për të

gjitha provat që synon t'i publikojë deri më 1 prill 2025. Ky është afati që prokuroria e ka dhënë për mbylljen e rastit ndaj liderëve të UÇK-së. "Së fundi, në përputhje me sugjerimin që bëri mbrojtja e Thaçit, trupi gjykues urdhëron ZPS-në të na japë një planifikim të hollësishëm se si planifikon t'i paraqesë provat deri më 1 prill 2025. Ky plan duhet t'i jepet trupit gjykues jo më vonë se 21 qershori 2024. Kjo duhet t'i përfshijë: dëshmitarët që kërkon të thërrasë gjatë kësaj periudhe kohore dhe rendin, orët që mendon se nevojiten për pyetje të Prokurorisë, cilët dëshmitarë do të

jenë sipas rregullës 153, dhe cilët sipas rregullës 154, cilët dëshmitarë të mbetur do të përdoren sipas rregullës 155 për periudhën e mbetur, gjashtë çdo mocioni jогоjor që do të dorëzohet, cilët prej dëshmitarëve do të jenë me videolidhje, dhe të artikulojë çdo faktor në zbatimin e planifikimit të propozuar", ka thënë Smith.

Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, ka filluar në prill të vitit 2023, ndërsa ata janë duke u mbajtur në paraburgim nga nëntori i vitit 2020.



Ahmeti: Do ta mbrojmë legjitimitetin e votës së shqiptarëve

SHKUP, 29 MAJ - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, tha të mërkurën në Tetovë se Fronti Evropian është përfaqësues legjitim i shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut dhe jo koalicioni VLEN, që tani është pjesë e shumicës së re parlamentare dhe pritet të jetë pjesë e qeverisë së re.

Ahmeti tha se BDI-ja dhe Fronti Evropian janë përfaqësues legjitimë të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, andaj edhe paralajmëroi "aktivitete për mbrojtjen e votës së shqiptarëve". Në paraqitjen para medieve së bashku me drejtuesit e Frontit Evropian që përbëhet nga disa parti shqiptare dhe katër parti të etniteteve të tjera, Ahmeti tha se çdo përpjekje për të "shkelur në vullnetin e shqiptarëve dhe të komuniteteve të tjera do të kundërshtohet fuqishëm nga Fronti Evropian".

Në bazë të rezultateve të KShZ-së,



në zgjedhjet parlamentare më 8 maj, Fronti Evropian ka fituar 18 mandate të deputetëve, kurse koalicioni VLEN, 14. "Vota juaj nuk guxon të shkojë huq dhe ne jemi këtu bashkë me ju që t'i prijmë fitores suaj dhe ta zbatojmë vullnetin tuaj si fitimtarë", tha Ahmeti duke mos sqaruar se çfarë

masash do të ndërmerren në mbrojtje të asaj që ai e quan "legjitimitet i shqiptarëve".

Por, drejtuesit e koalicionit VLEN, gjithashtu, pretendojnë se janë përfaqësues legjitimë pasi thonë se ka fituar "vota të pastra shqiptare" kundrejt Frontit Evropian që në zgjedhje ka marrë

vota edhe nga bashkësitë e tjera etnike.

Kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, tha se opinionin me kohë do të njoftohet me masat që do të ndërmerren, duke theksuar se do të shfrytëzohen të gjithë "mekanizmat" për mbrojtjen e "fitores" në zgjedhjet e 8 majit.

I pyetur nëse braktisja e punimeve të Kuvendit të martën, në të cilën Afrim Gashi nga koalicioni VLEN dhe VMRO DPMNE-ja u zgjodh për kryetar të Kuvendit, Ahmeti tha se "ndihet i fyer të qëndronte në një seancë të tillë. "Nuk bëhet fjalë për bojkot. Ne do t'i shfrytëzojmë të gjithë mekanizmat demokratikë për mbrojtjen e legjitimitetit të fituar. Ne morëm pjesë në Kuvend në verifikimin e mandateve, por e braktisëm sallën sepse ndiheshin të fyer pasi po shkelej legjitimiteti i të gjitha atyre që votuan më 8 maj", u shpreh Ahmeti.

Ai akuzoi drejtuesit e koalicionit VLEN për shkeljen e një

marrëveshjeje që, sipas Ahmetit, është arritur mes partive shqiptare qysh në fund të vitit të kaluar se asnjë parti shqiptare nuk do të jetë pjesë e qeverisë së re pa marrjen e garancive për miratimin e ndryshimeve kushtetuese dhe vazhdimin e integritetit evropian".

Kreu i BDI-së, Ahmeti, tha se përgjegjësia mbi të gjitha zhvillimet e mëtejme në Maqedoninë e Veriut, bie mbi mandatarin për formimin e Qeverisë së re, Hristijan Mickovski. Ai akuzoi VMRO DPMNE-në se gjatë viteve të fundit ka udhëhequr politikë antishqiptare me deklarata "naziste", si dhe politikë kundër Bashkimit Evropian, NATO-s, ShBA-së si dhe kundër marrëveshjeve ndërkombëtare. "Ne jemi në mbrojtje të legjitimitetit dhe fare nuk tërhiqemi. Qerpiku nuk na dridhet, sepse jemi në të drejtën tonë", tha Ahmeti.

Erdogani kritikon ashpër OKB-në për luftën në Gazë

ANKARA, 29 MAJ - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, kritikoi ashpër Kombet e Bashkuara dhe i bëri thirrje "botës islamike" të reagojë pas sulmeve të fundit vdekjeprurëse izraelite në Gazë. "OKB-ja nuk mund ta mbrojë as stafin e vet. Çfarë po prisni që të veproni? Shpirti i OKB-së është i vdekur në Gazë", tha Erdogan para ligjvënësve të partisë së tij, AKP, më 29 maj.

Deklaratat e Erdoganit vijnë në ditën kur Këshilli i Sigurimit i OKB-së do të takohet për të diskutuar për sulmet e fundit të Izraelit në një kamp në Rafah.

Sulmi i fundit në një kamp në perëndim të Rafahut të martën la të vrarë 21 persona, sipas zyrtarëve të Mbrojtjes Civile në Gazë e udhëhequr nga Hamasi, grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Po ashtu, të dielën u vranë dhjetëra persona në një kamp në Rafah.

Presidenti turk, po ashtu, kritikoi shtetet me shumicë myslimane për dështim që të marrin një veprim të përbashkët sa iu përket sulmeve izraelite. "I kam disa fjalë



që dua t'ia them botës islamike: çfarë po prisni që të merrni një vendim të përbashkët", tha

Erdogani. "Izraeli nuk është vetëm kërcënim për Gazën, por për gjithë njerëzimin", shtoi ai.

Sipas presidentit turk, asnjë shtet "më nuk është i sigurt pasi që Izraeli nuk respekton ligjin ndërkombëtar", duke përsëritur akuzën e tij se Izraeli po kryen "gjenocid" në Gazë.

Që kur ka nisur lufta në Gazë në mes të Izraelit dhe Hamasit, Erdogan vazhdimisht ka kritikuar Izraelin për veprimet në këtë territor palestinez.

Erdogani, po ashtu, ka thënë se nuk e konsideron Hamasin organizatë terroriste dhe, sipas tij, është një grup luftues për çlirim dhe mbrojtjen e tokave palestineze.

Trajtimi i lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, GLPS: Kohëzgjatja mesatare për zgjidhjen e tyre, 688 ditë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 MAJ - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka publikuar raportin e trajtimit institucional të rasteve të korrupsionit: Sfidat e sistemit gjyqësor gjatë një viti.

Ky raport, i publikuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, fokusohet në monitorimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, me theks të veçantë në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky raport është rezultat i monitorimit të seancave gjyqësore dhe vendimeve të marra nga gjykatat gjatë periudhës 1 prill 2023 - 31 mars 2024.

Raporti i prezantuar përfshin gjetjet nga 458 seanca gjyqësore të monitoruara, nga të cilat 322 janë zhvilluar dhe 127 janë mbajtur me vonesë ose janë anuluar. Gjithashtu, janë analizuar 143 aktgjykime të publikuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Në gjetjet kryesore të prezantuara të raportit thuhet se numri i lartë i seancave të anuluar apo të mbajtura me vonesë, kontribuon ndjeshëm në zvarritjen e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit. Po ashtu thuhet se arsyeja kryesore e këtyre



vonesave është mosparaqitja e palëve në gjykim dhe neglizhimi i gjykatave në lëshimin e urdhrave të arrestit. Po ashtu, shumë seanca dështojnë për çështje teknike dhe administrative, përfshirë mungesën e personelit kyç dhe planifikimin e dobët. "Prishtina ka pasur numrin më të madh të aktgjykimeve të publikuara (43), ndjekur nga Mitrovica dhe Gjilani (25). Kohëzgjatja mesatare për

zgjidhjen e rasteve të korrupsionit ishte 688 ditë, me variacione rajonale të dukshme. Nga 143 aktgjykime, 89 ishin aktgjykime dënuese. Nga këto 89, 51 ishin dënime me gjobë, 9 me burg, 6 me burg dhe gjobë, dhe 1 me gjobë dhe burgim me kusht. Dënimet plotësuese të ndalimit të ushtrimit të funksionit në administratën publike janë aplikuar rrallë", është theksuar në prezantimin e këtij raportit.

Në tryezën e organizuar morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Policia e Kosovës, Bashkimi Evropian, EULEX, OSCE, një gjyqtare e Apelit, Zyra e Kryeministrit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Këshilli i Evropës/PECK III si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në fillim të prezantimit, drejtoresha ekzekutive e GLPS-së, Arbëresha Loxha-Stubulla, ka falënderuar pjesëmarrësit dhe

panelistët për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë në diskutim. Ajo, po ashtu, prezantoi projektin Përkrahja e Reformës së Administratës Publike dhe Sundimit të Ligjit përmes Luftimit të Korrupsionit dhe Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve (Act Now) duke vënë theksin në përpjekjet e GLPS-së për monitorimin e institucioneve për trajtim të rasteve të korrupsionit. Udhëheqësi i ekipit për sundim të ligjit në zyrën e BE-së, Nicola Scaramuzzo, ka theksuar angazhimin e BE-së për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin duke financuar projekte të zbatuara si nga organizatat kombëtare të shoqërisë civile, po ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare. Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, ka theksuar se trajtimi i korrupsionit është prioritet i Ministrisë së Drejtësisë dhe se kjo po bëhet përmes pakos së re të legjislacionit kundër korrupsionit dhe avancimit të procesit të vettingut. Kurse përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, Fidan Haliti, ka thënë se politikat ndëshkimore duhet të jenë në përputhje me ligjin në mënyrë që të ndalohet korrupsioni. Së shpejti GLPS do ta publikojë raportin final me gjetjet dhe rekomandimet për sistemin gjyqësor.

Konjufca: Janë zvogëluar shanset për shpërndarjen e Kuvendit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 MAJ - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se ditët e fundit janë "zvogëluar shanset për shpërndarjen e Kuvendit". Arsye për këtë, sipas tij, është mungesa e konsensusit të partive politike për mënyrën se si të shkohet në zgjedhje të reja. "Por, nëse nuk arrihet konsensus që të jemi të sigurt që kemi dukshëm mbi numrin 80 dhe jo që të jemi në kufi, sepse mund edhe të mos bëhet shpërndarja e Kuvendit, ju e dini kërkon dy të tretat e votave. Vetëm mazhoranca me PDK-në do të ishin në kufi të këtyre numrave. Kjo është arsyeja pse kemi kërkuar konsensus më të gjerë. Në kampin opozitar nuk ka pasur pajtueshmëri, kështu që unë mendoj se goxha shumë ditët e fundit janë zvogëluar shanset që Kuvendi të shpërndahet", ka deklaruar Konjufca të mërkurën.

Sipas kryeparlamentarit

Konjufca, afati i fundit për të arritur një konsensus mes partive politike për shpërndarjen e Kuvendit dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme do të ishte java e parë e qershorit. "Nëse shkon java e parë e qershorit dhe ne për zgjedhje të jashtëzakonshme do të hynim në javën e parë të korrikut, atëherë nëse kalojnë këta kufij kohorë, ne nuk do të kemi zgjedhje të parakohshme. Atëherë, mandati do të konsumohet i plotë nga qeveria dhe mazhoranca", ka thënë kryeparlamentari Konjufca.

Mandati i Qeverisë së Kosovës, udhëhequr nga Albin Kurti, përfundon në fillim të vitit 2025, por partitë opozitare ka kohë që kërkojnë mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, duke e cilësuar atë si të "dëmshme për vendin". Subjekti më i madh opozitar, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), mbështet shpërndarjen e Kuvendit. Por, dy partitë e tjera opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK),



duan zgjedhje të reja përmes shkarkimit apo dorëheqjes së qeverisë së kryeministrit Albin Kurti. Megjithatë, Lëvizja Vetëvendosje e Kurtit ka përjashtuar mundësinë që në zgjedhje të shkohet përmes dorëheqjes së ekzekutivit.

Kryeministri Kurti është shprehur i hapur për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Ai ka thënë se do të ishte mirë që zgjedhjet e reja të mbaheshin në pranverë ose në vjeshtën e këtij viti. Për shpërndarjen e Kuvendit,

nevojitet mbledhja e 40 nënshkrimeve për mocionin paraprakisht, i cili pastaj duhet të votohet nga 80 ligjvënës. Prej se Kosova është bërë shtet i pavarur në vitin 2008, asnjë qeveri e zgjedhur nuk e ka çuar deri në fund mandatin 4-vjeçar.



Krasniqi: Mundësia për shpërndarjen e Kuvendit është shteruar, i habitur që partitë e tjera opozitare s'patën gatishmëri

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka bërë me dije të mërkurën se është ezauruar mundësia e shpërndarjes së Kuvendit. “Thirrja dhe propozimi i PDK-së për koordinim mes partive më të mëdha politike në vend që të shpërndajmë Kuvendin nuk ka gjetur mbështetjen e nevojshme. Unë mund të hamendësoj për arsyet e gatishmërisë deklarative të partisë në pushtet për të shkuar në zgjedhje të parakohshme, por vërtet jam i habitur nga mosgatishmëria e partive opozitare për ta bërë një gjë të tillë, sepse mosshkuarja në zgjedhje, efektivisht po ia zgjatë mandatin pushtetit aktual”, ka thënë Krasniqi në konferencën për medie

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në një konferencë për media të mërkurën ka bërë me dije se është ezauruar mundësia e shpërndarjes së Kuvendit. Krasniqi tha se propozimi i PDK-së për shpërndarjen e Kuvendit nuk ka marrë mbështetjen e duhur. “Sot, më 29 maj, ashtu siç e kam cekur si afat në letrën e dërguar tre liderëve politikë të partive parlamentare shqiptare, duke ndier keqardhje për shtetin dhe qytetarët, ju njoftoj se mundësia për shpërndarjen e Kuvendit tashmë është

ezauruar. Thirrja dhe propozimi i PDK-së për koordinim mes partive më të mëdha politike në vend që ta shpërndajmë Kuvendin nuk ka gjetur mbështetjen e nevojshme. Unë mund të hamendësoj për arsyet e gatishmërisë deklarative të partisë në pushtet për të shkuar në zgjedhje të parakohshme, por vërtet jam i habitur nga mosgatishmëria e partive opozitare për ta bërë një gjë të tillë, sepse mosshkuarja në zgjedhje efektivisht po ia zgjatë mandatin pushtetit aktual”, ka thënë Krasniqi. Krasniqi ka thënë se në tri vitet e fundit jemi dëshmitarë të një stagnimi të madh ekonomik, të rritjes enorme të çmimeve që ka rezultuar me përkeqësim të

mirëqenies së qytetarëve. “Dëshmitarë të izolimit diplomatik - i shpërfaqur me masa ndëshkuese ndaj shtetit tonë e posaçërisht së fundmi me mos-futjen në agjendë të Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës; dëshmitarë të regresit të theksuar në arsim e shëndetësi, po ashtu emigrimit të madh të qytetarëve. Duke marrë parasysh të gjitha këto arsye, të cilat janë pasojë e një qeverie jokompetente dhe të papërgjegjshme, Partia Demokratike e Kosovës ka konsideruar se zgjidhja më e mirë janë zgjedhjet e parakohshme”, ka thënë ai. Ai ka thënë se për këtë arsye ka pranuar edhe ftesën e kryeministrit Kurti për takim më 13 maj, duke bërë të qartë se PDK-ja takohet vetëm për ta diskutuar datën e zgjedhjeve të reja. “Të gjithë e dini epilogun e atij takimi: PDK doli me qëndrimin e saj dhe, madje, propozoi edhe dy data konkrete për zgjedhje të parakohshme: 30 qershorin dhe 7 korrikun. Më lejoni të ritheksoj se Partia Demokratike e Kosovës ka qenë dhe është gjithmonë e gatshme për cilindo variant që mundëson zgjedhje të parakohshme dhe largimin e kësaj qeverie. Edhe për ne

dorëheqja ka qenë mënyra e preferuar e shkuarjes në zgjedhje, por të gjithë e dimë që si mundësi reale në tavolinë ishte vetëm shpërndarja e Kuvendit. Prandaj, duke e parë nevojën e madhe që vendi të shkojë në zgjedhje, për ne kishte më shumë rëndësi qëllimi sesa mënyra”, ka thënë ai. Krasniqi ka shtuar se gjatë kësaj periudhe PDK-ja ka dëshmuar seriozitetin e saj për t'i dhënë fund keqqeverisjes dhe gatishmërisë së saj për zgjedhje të parakohshme në shumë raste. “Këtë e dëshmuam edhe kur nominuam si kandidat për kryeministër Bedri Hamzën më 27 mars të këtij viti. Këtë e dëshmuam edhe të premtën, më 24 maj, kur PDK u paraqit në sallën e Kuvendit të Kosovës për t'iu përgjigjur rezolutës së AAK-së për shkarkimin ose dorëheqjen e qeverisë. Këtë e ridëshmuam për të satën herë edhe përmes letrës së fundit që ua dërgova kryetarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Si PDK tash e shumë muaj kemi konsideruar se vendi ka nevojë për një qeveri të re, kredibile, të aftë dhe të përgjegjshme, e cila e rikthen Kosovën në kursin e zhvillimit dhe integritit. Kosova po humb

kohë të vlefshme, procese të rëndësishme e miq me vlerë - si pasojë e këtij mentaliteti qeverisës. Ne jemi të bindur se fundi i kësaj qeverie do të nënkuptonte një fillim të ri për shtetin tonë. Për fat të keq, kolegët tanë nga partitë opozitare nuk ishin të gatshëm njësoj si ne. Ndoshta atyre u duhet më shumë kohë, por koha nën këtë qeverisje po shkon në dëm të qytetarëve”, është shprehur Krasniqi. Ai ka thënë se shpreson që deri në përfundim të mandatin të qeverisë Kurti 2, Kosova dhe qytetarët tanë nuk do të marrin ndonjë goditje të re, nga brenda ose nga jashtë, që do të ishte me pasoja të rënda dhe afatgjatë. “Partia Demokratike e Kosovës do të vazhdojë të jetë zëri më i fuqishëm opozitar në vend, duke i kundërshtuar politikat e gabuara të kësaj qeverie. Në të njëjtën kohë, do të vazhdojmë ta ofrojmë alternativën më të mirë për qytetarët e Kosovës, përmes vizionit dhe programit të kandidatit tonë për kryeministër, Bedri Hamza dhe ekipit të tij. Një alternativë që i jep Kosovës një qeveri të përgjegjshme dhe kompetente, që në qendër e vendosë interesin qytetar, e për të cilën ka aq shumë nevojë Kosova, sot”, ka thënë Krasniqi.

Osmani e ashpër me Konjufcën dhe qeverinë: Oferta për KiE-n ndryshoi zotimet e liderëve për Asociacionin

PRISHTINË, 29 MAJ - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në një deklaratë për Ekonomia Online, i është kundërpërgjigjur kryeparlamentarit Glauk Konjufca për mosinformim rreth letrës që ministrja e Jashtme, Gërvalla, e kishte dërguar në Këshillin e Evropës, duke e arsyetuar se Osmani ka qenë në vizitë jashtë vendit. Këtë deklaratë të Konjufcës e para e shtetit e ka quajtur qesharake, duke thënë se në kohën moderne ekzistojnë mundësitë e shumta të komunikimit siç është telefoni.

Osmani ka thënë se pas letrës së dërguar nga kryediplomatja Donika Gërvalla ka rënë në ujë oferta e nënshkruar nga tre liderët institucionalë që nuk duhet të ketë zbatim të njëanshëm të marrëveshjes vetëm nga Kosova. "Unë nuk e kam dëgjuar një deklaratë të tillë. Do të befasohesha jashtëzakonisht shumë në qoftë se dikush vërtet deklaron diçka

të tillë sepse jemi në vitin 2024, ku telefonat funksionojnë shumë mirë, pavarësisht në cilën zonë kohore jemi. Në të njëjtën kohë të gjitha komunikimet tona deri tani në këto tri vite e gjysmë të bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e politikës së jashtme kanë qenë pikërisht përmes telefonit, sepse dikush nga institucionet gjithnjë ka qenë jashtë vendit. Të gjitha kanë rënë në ujë me ofertën që është bërë atë ditë, sepse ajo ofertë nuk ka qenë as për nga përmbajtja e as për nga procedura vazhdimësi e listës së zotimeve që e kanë nënshkruar të tre liderët, prandaj është domosdoshmëri kushtetuese në përputhje me nenin 84 që qeveria ta koordinojë një veprim të tillë me udhëheqësen e politikës së jashtme, që sipas Kushtetutës sonë, gjithnjë ka qenë dhe mbetet institucioni i Presidencës, në anën tjetër të thuhet se kjo në çfarëdo mënyre



paska pasur të bëjë me largësinë për mua. Pra është diçka që nuk dua ta besoj që dikush e thotë, sepse nuk ka fare të bëjë me

realitetin dhe tregon që në njëfarë mënyrë po tentohet që ky moskoordinim për një çështje kaq kapitale të lihet si faj te

Presidenca që për mua është vërtet qesharake", ka thënë Osmani.

E para e shtetit ka shtruar një pyetje për Konjufcën e ekzekutivin se si dikush në Gjermani e kuptoi për letrën që po i dërgohej KiE-s e asaj nuk i ishte dërguar me arsyetimin se ka qenë jashtë vendit. "Në qoftë se tema paska qenë te mosprezenca fizike në Kosovë, atëherë si është e mundur që një njeri nga shoqëria civile në Gjermani që, po ashtu, nuk ishte prezent në Kosovë, e mori atë letrë para Presidencës së vendit, para Parlamentit të vendit, para shoqërisë civile në Kosovë, para popullit të Kosovës dhe e botoi atë në 'Twitter'. Pra ta informosh një person që fare nuk është në institucione paska pasur mënyra, kurse për ta koordinuar dhe vendosur bashkërisht një temë të tillë nuk paska pasur mënyra që të koordinohet me presidenten. Kjo vërtet është qesharake", ka thënë Osmani.

Kosova përshëndet zgjedhjen e Afrim Gashit në krye të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut

Prishtinë, 29 maj - Deputeti i Koalicionit VLEN, Afrim Gashi, është zgjedhur kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Liderët e Kosovës e kanë uruar Gashin për pozitën e tij të re.

Presidentja Vjosa Osmani në "X", derisa ka uruar Gashin për zgjedhjen në krye të Kuvendit, ka thënë se shqiptarët kanë luajtur rol kyç në shtetformimin dhe shtetndërtimin e Maqedonisë së Veriut. "Urime kryetarit të sapozgjedhur të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, z. Afrim Gashi. Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut kanë luajtur rol kyç në shtetformimin dhe shtetndërtimin e Maqedonisë së Veriut, ndërkaq sot janë



kontribuues kyç për marrëdhënie të shkëlqyera perspektivën evropiane të saj. Shtetet tona gëzojnë të ndërsjellë, miqësi e

bashkëpunim. I uroj kryetarit Gashi shumë suksese në këtë pozitë të rëndësishme!", ka shkruar Osmani.

Edhe kryeparlamentari Galuk Konjufca e ka uruar Gashin për zgjedhjen kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. "Do të jetë shumë kënaqësi të punojmë së bashku, për ta thelluar bashkëpunimin mes vendeve tona, përfshirë atë të institucioneve tona parlamentare. Mezi pres t'ia nisim punës për t'i çuar përpara sa më shumë interesat tona të përbashkëta, për të kontribuar bashkërisht drejt stabilitetit të qëndrueshëm rajonal dhe synimeve euroatlantike. Pres që

marrëdhëniet mes institucioneve tona të konsolidohen edhe më tutje", ka shkruar Konjufca.

Ai ka shtuar se shqiptarët janë jo vetëm shenjë demografie, por edhe demokracie në politikën e Maqedonisë së Veriut, prandaj akti mes lirisë dhe barazisë së qytetarëve u respektua sot me zgjedhjen e Gashit kryeparlamentar, duke lënë pritshmërinë e vijimit në frymën gjithëpërfshirëse. "Uroj që ligjet, praktikat dhe kultura demokratike të na sjellë edhe më afër si vizion për një të ardhme sa më premtuese për të dy vendet tona", ka deklaruar Konjufca.

LDK-ja: Kurti duhet të japë dorëheqje, pastaj të caktohet data e zgjedhjeve



Prishtinë, 29 maj - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur mbledhjen e dytë të Këshillit të Përgjithshëm, në të cilën është diskutuar rreth tri pikave të rendit të ditës, fillimisht diskutim i përgjithshëm mbi gjendjen politike dhe zhvillimeve të fundit në vend, si dhe autorizimin e Këshillit të Përgjithshëm që Kryesia e LDK-së dhe kryetari Abdixhiku t'i vazhdojnë veprimet parazgjedhore. Unanimisht Këshilli i Përgjithshëm, po ashtu, miratoi

qëndrimin e kryetarit Lumir Abdixhiku dhe të kryesisë lidhur me zgjedhjet e parakohshme në vend, ku qëndrimi i Lidhjes Demokratike mbetet i njëjtë. Kryeministri duhet të japë dorëheqje për dështimet e tij në çdo fushë, pastaj të bëhet shpërndarja e Kuvendit dhe krejt në fund të caktohet data e zgjedhjeve.

Gjatë kësaj mbledhje Këshilli i Përgjithshëm aprovoi kuotën e ndarjes së nominimeve për listën e deputetëve nëpër degët e Lidhjes Demokratike. Në listën e

kandidatëve për deputetë do të jenë të gjithë kryetarët e komunave të LDK-së, për arsye që e djalta të jetë sa më e fuqishme në zgjedhjet e ardhshme të Kosovës të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me fatin e LDK-së, por fatin e Republikës dhe gjeneratave që vijnë.

LDK-ja në këtë mbledhje ka theksuar se është e gatshme për zgjedhjet kurdo që mbahen në Kosovë, prandaj është e vetmja parti që po bën të gjitha përgatitjet dhe po vazhdon takimet me qytetarë anekënd vendit.

Ali Ajeti - vigjilenti lirishtës

(Në 35-vjetorin e rënies heroike)

Basrie MURATI- SAKIRI

Dalja n'mal

Ishte e martë, më 27 marsit të vitit 1989, kur për herë të parë e njoha Ali Ajetin. Po atë ditë u zhvillua një demonstratë e madhe nëpër rrugët e sheshit të Podujevës si dhe qyteteve të tjera të Kosovës. Ne demonstruam kundër heqjes të statusit të autonomisë të Kosovës. Mijëra llapjanë, shumica e tyre rini, nxënës e studentë,

shprehnin pakënaqësinë para tankeve e policisë speciale të mobilizuara e armatosur, duke brohoritur parulla për liri, barazi e kushtetutë. Atë ditë edhe ndërtesat kishin marrë pamje tjetër. Sikur ishin bërë sy e vesh dhe vështronin gjithë atë popull, që për herë të parë kishte dalë pas aq vitesh ashtu i bashkuar të demonstronte për liri dhe barazi. Qyteza jonë dukej krenare, sepse llapjanët i madh e i vogël kishin dalë të protestonin. Derisa ne kërkonim vetëm të drejtat tona, të drejtën për të jetuar si njerëz e për të ekzistuar si komb, armiku përgjaku rrugët e Podujevës me vrasjen e të riut të pafajshëm, Mehmet Ejupi.

Asnjëherë më parë nuk e kisha parë Podujevën aq të vogël. Njerëzit e shumtë i kishin zënë të gjitha rrugët. Të shtyrë nga njëri-tjetri, radhë-radhë, ta merrte mendja se nuk do të ketë as ajër të mjaftueshëm për të gjithë ata njerëz. Fshatarë e druvarë, pleq e vajza, të cilët kishin harruar dertet e tyre të përditshme. Atë ditë shiheshin çanta të nxënësve nëpër tokë. E, çfarë nuk të zinte syri atë ditë? Të gjithë së bashku demonstronim para policisë e njërive speciale, që ishin të armatosur e të mbështjellë me mbrojtëse. Njëkohësisht mbi kokat tona dëgjohej zhurma e helikopterëve të armikut serb, që fluturonin shumë ulët mbi qytet dhe shpërndanin nga lart gazin lotsjellës.

Në mes të asaj vale që i vinte erë luftime, bëja krahasim në mes demonstruesve dhe policëve: ata ishin të pajisur me jelekë antiplumb e të armatosur, ndërsa ne duarthatë! Megjithatë, ne rezistonim. Ne e ndienim veten më të guximshëm dhe më të fuqishëm se asnjëherë më parë, ngase kishim moralin që na bënte të fortë.

Dikur vonë pasdite, njëri nga bashkëveprimtarët, Ismet Abdullahu, e që atëherë e njihja me pseudonimin "Shpend", na paralajmëroi, një shoqen timen të gjimnazit, Ganimete Abdullahu, dhe mua, që disa nga grupi ynë të mos shkojmë në shtëpi, ngase ishim të rrezikuar nga organet e sigurimit, por të shkonim në një mal në fshatin Dumnicë, sepse atje mbledheshin edhe të tjerët, gjë që ashtu vepruam.

Para përdimit të diellit, morëm rrugën për në atë malin. Unë nuk e dija se ku ishte ai vend, prandaj një ndjenjë pasigurie filloj t'më përshkoj, mirëpo Ganimetja, e cila vinte po nga Dumnicë, më pati ngushëlluar, që t'mos merakoshesha, sepse ajo e dinte se ku ishte. Me rënien e errësirës, të lagur nëpër përroskat e fshatit Livadicë e Dumnicë, të lodhur nga demonstrimi e të helmuar nga tymi i bombave lotsjellëse, me shumë mund ia arritëm ta gjenim përafërsisht vendtakimin. Kur arritëm në atë malin, filluam të merakoseshim, sepse nuk vërehej shenjë jete lart e gjerë dhe nuk i gjenim shokët. Pasi fishkëlyem disa herë, sipas marrëveshjes me "Shpendin", dikush na e ktheu përgjigjen nga ana tjetër po me të njëjtën fishkëllimë. Në fytyrën e njëra-tjetres e vërejtëm një gëzim. Në të vërtetë nuk ishte gëzim, ishte një lehtësim, se atypari ishin shokët që i kërkonim, e nuk do të ishim vetëm.

Ata ishin fshehur nëpër kaçuba dhe dilnin një nga një. Prej tyre njoha vetëm "Shpendin" dhe dy shokë gjimnazi, Fatmir Sfishten e Halim Rrmokun. Kur i pashë me pushkë në duar e të shtrenguar tamam si në gjendje luftime, m'u hodh mendja t'i përqafoja si luftëtarë të lirisë, por e përmbajta veten. Të njëjtën gëzim e shihja edhe në sytë e Ganes dhe të Fatmirit e Halimit. Kurse tre të tjerët, të cilët ishin në mesin e tyre, dukeshin më të shtyrë në moshë. Të gjithë na përshëndetën ngrohtë, por pa u prezantuar se kush janë. Ishte kohë e rrezikshme, prandaj personat nuk prezantoheshin fare ose vetëm me pseudonim. Secili nga ne filloi të tregonte në mënyrën e tij përshtypjet dhe përjetimet që i kishte për ngjarjet e ditës së sapokaluar.

Nga rruga që vinte prej Serbisë për në Podujevë dëgjohej zhurma e madhe e zinxhirëve të tankeve ushtarake të pafundme. Aq shumë kaluan nëpër atë rrugë, sa të bënte të mendosh, se të nesërmen Kosova do të kishte më shumë tanke se sa njerëz. Një i ftohtë marsi filloj të kaploj natën dhe nuk mund të qëndronim më jashtë. Dikur pas mesnate, vendosëm të shkonim në një shtëpi të vogël e të vjetër aty afër, që ishte e pabanuar dhe i ngjante një shtëpie bariu në malësi. As aty nuk ishte më nxehtë se sa në mal, sepse ishte e shtruar vetëm në çimento. Kishte pak kashtë, por ajo s'na mjaftonte as për t'u ulur. Sa e mbaj në mend, dritaret nuk kanë pasur xhama fare. Të paktën toka nuk kishte lagështi.

Nga të ftohtit, por edhe nga të ecurit e të vrapuarit gjatë tërë ditës, filluan këmbët të më dhembnin, sa që nuk mund të zija vend. Edhe një shok aty afër meje, kishte të


njëjtin hall, ku të shumtën e kohës e kalonte duke ecur nëpër dhomë, në mënyrë që të mos i ndiente dhimbjet. Nga keqardhja, por pak edhe nga kureshtja, dikur e pyeta me zë të ultë se si e quanin dhe nga ishte. Pa hezituar, ai më tha se e quanin Ali dhe ishte nga Sfeçla. Më çuditi përgjigja e tij e rreptë dhe e drejtpërdrejtë, ngase në atë kohë shumica vepronin me pseudonim dhe nuk tregonin prejardhjen, për shkaqe konspiracioni. Ai nuk fliste shumë, prandaj të linte përshtypjen e një njeriu sa të matur e me përvojë, aq edhe të dashur.

Dikur më vonë erdhën edhe katër apo pesë persona të tjerë, të cilët duhej të ishin po ashtu shokë të idealit. Ne nuk i dalluam kush ishin ata, sepse ishte errësirë e dendur. Mirëpo nga bisedat e tyre kuptohej se ishin me përvojë. Ata thanë se gjendja është shumë e vështirë dhe se të nesërmen mund të jetë i rrethuar i tërë qyteti nga ushtria serbe. Të gjithë, në atë shtëpi të vogël, e vumë nga pak kashtë nën kokë, se nuk kishte më tepër, u shtrimë për të bërë një sy gjumë. U zgjuam ende pa aguar dita. Na zgjoi pikërisht ai shoku i cili kishte dhimbje të këmbëve, Aliu, i cili kishte bërë rojë deri në agim. Përdryshe, edhe pse në çimento, gjumi s'do të na kishte dalë deri në mesditë, aq të lodhur e të rraskapitur që ishim.

Strehimi te baca Hasan Ramadani

27 marsi 1989 mbeti për mua datë historike, jo vetëm për shkak të zhvillimit të demonstratës së madhe e të rënies të Mehmet Ejupit, por edhe pse, që nga ajo ditë disa nga aktivistët që vepronin kundër padrejtësive që na bëheshin nga regjimi serb, u arratisëm në ilegalitet. Ajo periudhë mbijetimi për ne ishte e mbushur përplot vështirësi, ku përndonjërën zgjati më shumë e për disa të tjerë më pak.

Në mëbrëmjen e 29 marsit ne u përshëndetëm me familjen bujare të Shaban Ajetit nga Miroci. Dolëm nga konaku i tij dhe morëm rrugën e arratisjes. Nëpër atë errësirë të dendur dhe nëpër ato brigje, që as vet nuk e dija se ku të shpinin, duhej kërkuar vendstrehim. Me armët në duar e me frikën se mos na diktonte armiku, të shoqëruar me njëri-tjetrin, ecim dy nga dy. Ecja jonë mori fund vetëm aty kah mëngjesi. Kaluam nëpër kodrat e Shajkovcit e të Herticës, por nuk arritëm të gjenim bazën që e kërkonim. Ishte shumë ftohët dhe mërdhinim, mirëpo zjarr nuk guxonim të ndiznim, ngase mund të diktoheshim. Vendi ku u përqendruam ishte një mal i vogël. Vetëm pasi ka aguar mëngjesi kemi ndezur një zjarr, që të ngroheshim pak. Mundoheshim tymin ta zhdukim, që të mos dallohej nga të tjerët, qoftë



fshatarët apo nga policia. Edhe pse kishim më tepër se 24 orë pa fjetur fare, gjumi nuk na zinte nga të ftohtit. Ishim në një vend të pasigurt dhe po të vinin helikopterët, të cilët dëgjohehin aty-këtu nga larg, do të na vërenin menjëherë. Dikur kah ora 11:00 kemi ngrënë nga pak bukë, të cilën e kishin marrë me vete shokët. Nuk na hahej fare, por duhej patjetër, sepse rruga jonë nuk dihej se kur dhe ku do të mbaronte. Aliu me një kushëri të tij tregoheshin optimistë me fjalorin e tyre. Aliu përherë tregonte diçka me tematikë politike, që na bënte të qeshnim. Edhe pse përjetonim ato vuajtje e ishim të pasigurt, nëse do të ishte mëngjesi i fundit për ne, ata me humorin e tyre e thyenin sado pak atë monotonin që na kishte kapluar. Pasdite filloi të binte shi. Ne tanimë nuk mund të rrinim as ulur, se toka jo vetëm që ishte e ftohët, por edhe e lagur nga shiu. Megjithatë na u dash të kalonim ditën aty, deri sa u errësua. Me rënien e errësirës e morëm rrugën të shkonim te një fshatar në fshatin Shajkovc. Ai ishte Hasan Ramadani, atdhetar i flakët, tanimë heroi i kombit, që për neve nuk kurseu asgjë. Me gjithë rrezikun që i është kanosur, baca Hasan na ka mirëpritur zemërplot e si çlirimtar. Në fytyrën e tij heshtazi e kam vërejtur zemërgjerësinë dhe sakrificën e tij. Jetesa jonë në ilegalitet vështirësohej, kurse keqtrajtimi i familjarëve tanë rritej çdo ditë e

më tepër. Ne ishim të varur nga mbështetja e ndihma e popullit, përdryshe nuk kishim mundësi të mbijetonim me shumë se disa ditë, se lerë më me muaj të tërë në ilegalitet.

Më 17 maj të vitit 1989 disa nga shokët u shpërndanë në bazat tjera, në mënyrë që t'mos rrezikonim duke qenë të gjithë në një vend. Kurse Aliu e unë qëndruam në shtëpinë e Nezir Osmanit në Balloçë, i cili nuk kurseu asgjë për të na strehuar. Aliu, prej të gjithëve, ka qenë më i zbehur në fytyrë. Ndoshta se kishte qenë gjatë i burgosur. Ai ishte i matur dhe fliste pak, mirëpo humori i tij e thyente nganjëherë monotoninë që na mbyste. Në prezencën e tij e ndjeja veten si me vëllanë tim. Aty-këtu bisedonim për tema të ndryshme, veçanërisht nga koha e burgut, ku kishte qëndruar 5 vjet, deri në tetorin e vitit 1988, për shkak të aktiviteteve të tija kundër regjimit serb. Pasi ishte qetësi, kohën e kalonim duke lexuar. Bashkë, në atë bazë i patëm kaluar tri ditë, pra deri më 20 maj 1989. Deri atëherë kur erdhën edhe shokët tjerë, në mesin e të cilëve ishin edhe Sabri Kijçari e Shaban Mulloli. Ata na informuan në lidhje me situatën. Sipas tyre, policët ishin tërbuar më shumë se kurrë dhe kontrollonin në çdo kohë nëpër shtëpitë tona, tek familjarët, të afërmit e shokët tanë dhe i torturonin ata, në mënyrë që të tregonin se ku gjendeshim ne. (Vijon)

Thaçit i vazhdohet paraburgimi

HAGË, 29 MAJ - Ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i është vazhduar sërish masa e paraburgimit nga ana e Gjykatës Speciale. Vendimi është marrë më 24 maj, pasi që turpi gjyqësor ka konsideruar se po të lihej në liri, Thaçi do ta pengonte procesin gjyqësor. "Në konstatimin e fundit tregon se një rrezik i tillë vazhdon të ekzistojë. Paneli e riktheu vlerësimin e tij të mëparshëm se Thaçi ka interesin dhe aftësinë për të ndikuar në procedurat; (ii) ka tentuar të nënvlerësojë KSC-në dhe ka ofruar përfitime për

personat të thirrur nga SPO; (iii) ka një pozicion të ndikimit në Kosovë që mund t'i lejojë atij të përfitojë mbështetjen e simpatizantëve; dhe (iv) duke marrë parasysh gjyqin që po vazhdon, ka njohuri të shtuar për provat që mbështesin akuzat e rënda kundër tij. Për më tepër, ekziston një klimë e vazhdueshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe ndërhyrjen në procedurat penale kundër ish-anëtarëve të UÇK-së në Kosovë, çka Gjykata e Apelit ka pranuar si një 'konsideratë kontekstuale' relevante. Gjetje të

ngjashme u bënë në aktgjykimin për Mustafën dhe vendimin e Apelit për Gucatin dhe Haradinajn. Trupi gjyqësor vlerësoi se 'mbrojtja e dëshmitarëve ka vazhduar të jetë një çështje e rëndësishme dhe aktuale në Kosovë', dhe vuri më dukje dëshminë e ekspertit të mbrojtjes, Robert Reid, i cili tha se në mbi 20 vite në këtë fushë, ai kurrë nuk kishte parë kërcënim të dëshmitarëve në nivelin që ekziston në Kosovë", thuhet në vendimin e Speciales për vazhdimin e paraburgimit.



KFOR-i kërkon të mbahen përgjegjës personat që sulmuan në Zveçan



PRISHTINË, 29 MAJ - Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, kërkoj që të përfshirët në sulmet ndaj pjesëtarëve të këtij misioni në Zveçan vitin e kaluar të mbahen përgjegjës. Përmes një deklarate, në shënimin e njëvjetorit të protestave të dhunshme në Zveçan - komunë e banuar me shumicë serbe në veri të Kosovës - komandanti i misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, gjenerali Ozkan Ulutas, tha se më 29 maj 2023 pjesëtarët e këtij misioni parandaluan "përkallëzimin e mëtejshëm të dhunës".

Protestat e serbëve në veri të Kosovës, kundër kryetarëve shqiptarë në katër komunat atje,

kulmuan me përlëshje me pjesëtarët e KFOR-it një vit më parë.

Gjatë përlëshjeve, 93 pjesëtarë të KFOR-it u lënduan, disa prej të cilëve kishin lëndime të rënda. Në njëvjetorin e protestave të dhunshme, KFOR-i tha se sulmet ishin "të paprovokuara dhe krejtësisht të papranueshme". "Sot ne nderojmë shërbimin dhe sakrificën e kolegëve tanë, të cilët vunë në rrezik jetën e tyre për të kryer detyrat e tyre për të gjitha komunitetet në Kosovë, në përputhje me misionin tonë që del nga mandati i Kombeve të Bashkuara. Kuraja e tyre ndihmoi në stabilizimin e situatës në atë zonë dhe parandaloi

përkallëzimin e mëtejshëm të dhunës", tha Ulutas, sipas një njoftimi të misionit të NATO-s në Kosovë.

Kosova ka fajësuar Serbinë për ngjarjet në Zveçan, duke thënë se ato u kryen nga "grupe kriminale të afërta me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq".

Por, Serbia e mohoi një akuzë të tillë, duke e akuzuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, se dëshironte t'i shtynte serbët "drejt një konflikti me NATO-n".

Në Kosovë deri më tani janë arrestuar dhjetë persona për dhunën në protesta dhe për sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it. Më herët, KFOR-i ka deklaruar se shpresonte që Beogradi do të

hetonte edhe ata persona "që u kthyen në Serbi" pas trazirave, duke thënë se pret që të gjithë autorët "të ndiqen penalisht".

Mirëpo institucionet kompetente në Serbi ende nuk kanë komentuar për këtë çështje, gjegjësisht nuk dihet nëse autoritetet serbe janë duke zhvilluar ndonjë proces ndaj personave që morën pjesë në sulmin ndaj KFOR-it. Majin e vitit të kaluar serbët në veri protestuan kundër kryetarëve të rinj shqiptarë, që u zgjodhën në prill, pas bojkotimit të procesit zgjedhor nga serbët dhe partitë serbe. Dhuna në veri bëri që NATO të dislokonte afër 1 000 ushtarë shtesë. "Ne kemi rritur praninë tonë në veri të Kosovës, kemi

trefishuar patrullimet përfshirë përgjatë vijës kufitare administrative. Ky ishte përforsimi më i madh i kontingjentit tonë në Kosovë në një dekadë dhe tregon se NATO qëndron e gatshme të ruajë paqen", u tha në njoftimin e KFOR-it.

Për shkak të dhunës në veri majin e vitit të kaluar, por edhe sulmit ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit në shtator, KFOR-i rriti praninë ushtarake në Kosovë dhe tani ka rreth 4 700 ushtarë.

KFOR-i është përgjegjësi i tretë për sigurinë e Kosovës, pas Policisë së Kosovës dhe misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit, EULEX.

Përfundon renovimi i hapësirave të administratës komunale në Podujevë

PODUJEVË, 29 MAJ - Komuna e Podujevës ka njoftuar se ka përfunduar renovimi i hapësirave të administratës komunale në

katin përdhës. Nga tani e tutje një zyrat nga çdo drejtori do të qëndrojnë në katin përdhës për t'ua ofruar qytetarëve shërbimet e

nevojshme si dhe për t'u ndihmuar në çdo kërkesë ose pyetje që kanë.

Komuna ka njoftuar se ky

ndryshim është bërë me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe lehtësimin e marrjes së shërbimeve për qytetarët.



Kreu i ATK-së: Ka rritje të bizneseve që regjistrohen për çështje tatimore në veri

PRISHTINË, 29 MAJ - Drejtori i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka thënë se në veri është një realitet i ri dhe ekonomia është duke u formalizuar. Sipas tij, ka rritje të bizneseve që regjistrohen për çështje tatimore në veri të vendit. "Momentum i ri ka sjellë avantazh, në kuptimin e formalizimit të ekonomisë në atë pjesë të vendit tonë, me ç'rast në

ditët e fundit ka shtim të fluksit të bizneseve që regjistrohen për çështje tatimore dhe çështje të tjera në institucionet e Kosovës. Ka interesim me qëllim që të formalizohen. Kemi informata që dëshmojnë se në një të kaluar jo të largët, ka qenë e pamundur që biznese të shesin një mall me faturë. Tanimë është një realitet i ri. Ka biznese të regjistruar dhe shitjet këto

biznese në pjesën tjetër i bëjnë përmes procesit të formatizuar duke lëshuar fatura të rregullt", ka pohuar ai në RTV Dukagjini. Më tej, ai ka thënë se ky institucion tërë kohën e ka shtrirë autoritetin në veri të vendit. Megjithatë, Murtezaj ka shtuar se ende ka nevojë për përmirësime në atë pjesë të vendit. "Pa dyshim se të gjithë e dimë që pjesa veriore është një sfidë për të

gjithë institucionet, edhe për ATK-në, megjithatë duhet ta potencojmë faktin se edhe sot, edhe në kaluarën, ATK-ja e ka shtrirë autoritetin e vet edhe në pjesën veriore. Jo ndoshta në përmasat çfarë kërkohet dhe janë të nevojshme, mirëpo ka biznese atje që janë të regjistruara, të cilat vazhdojnë t'i paguajnë tatimet në buxhetin e Kosovës", ka thënë Murtezaj.



Kurti: Zvicra, një ndër investitorët kryesorë në Kosovë me 1.1 miliard euro investime

PRISHTINË, 29 MAJ - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministrja për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti, Rozeta Hajdari, zhvilluan një takim me anëtarët e Dhomës Ekonomike Zvicër - Kosovë. Në njoftimin për medie thuhet se kjo shoqatë e themeluar në vitin 2013 luan rol kyç në nxitjen e marrëdhënieve tregtare dhe investimeve ndërmjet dy vendeve tona, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme për kompanitë në aktivitetet e tyre komerciale dhe duke vepruar si një katalizator për zhvillimin ekonomik. "Gjatë takimit u diskutua për politikat më të fundit industriale dhe

tregtare, rëndësinë e diasporës së Kosovës në Zvicër, për procesin e sapopërfunduar të regjistrimit të popullsisë dhe progresin e deritanishëm në zbatimin e sistemit të arsimit dual. Ky i fundit, cilësohet nga qeveria me prioritet të lartë, si sistem kyç për ndërlidhjen e tregut me fuqinë punëtore", thuhet në njoftimin e qeverisë. Aktualisht janë 12 profile të ndryshme të arsimit dual në 14 komuna përreth vendit, me pritshmëri që në qershor të vitit të ardhshëm të dalin të parët absolutë me një certifikatë të zyrtarizuar të përfundimit të arsimit.



Më tej bëhet me dije se kryeministri Kurti theksoi se Zvicra ishte ndër shtetet e para që

njohu pavarësinë e Republikës së Kosovës më 27 shkurt 2008 dhe se ka qenë e mbetet një ndër

investitorët kryesorë në Kosovë, me vlerë investimesh prej rreth 1.1 miliard eurosh nga viti 2007 deri në fund të vitit 2023 dhe se Zvicra renditet si vendi i dytë për sa iu përket eksporteve më të mëdha të Kosovës.

"Gjatë bisedës u nënvizua që deri më tani Kosova dhe Zvicra kanë nënshkruar 18 marrëveshje të ratifikuara, 6 nisma për marrëveshje ndërkombëtare që mbulojnë bashkëpunimin teknik dhe financiar, aviacionin civil, lëvizjen e lirë të personave dhe mallrave, tregtinë, mbrojtjen e investimeve dhe sigurimet shoqërore", thuhet në fund të njoftimit.

Hoti: Bordi i Trustit Pensional, pa anëtarin nga Sindikatat, qeveria Kurti po nëpërkëmbë të drejtat sindikale

PRISHTINË, 29 MAJ - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë sot se mosëmërimi për gati një vit i anëtarit nga Sindikatat në Bordin e Trustit Pensional është shkelje ligjore, që nuk duhet të kalojë pa dhënë përgjegjësi nga shkelësit e ligjit.

Hoti në "Facebook" ka shkruar se të drejtat sindikale në Kosovë janë nëpërkëmbur nga qeveria Kurti në vazhdimësi. "Mosëmërimi për gati një vit i anëtarit nga sindikatat në Bordin e Trustit Pensional është shkelje ligjore, që nuk duhet të kalojë pa dhënë përgjegjësi nga shkelësit e ligjit. Të drejtat sindikale në Kosovë janë nëpërkëmbur nga Qeveria Kurti në vazhdimësi. Reagimi i fundit i IKD-së është



dëshmi shtesë për këtë. Një anëtar i Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale, i cili përfaqëson punëtorët dhe vjen nga sindikatat, nuk u emërua asnjëherë. Fillimisht, Trusti u la pa bord për disa muaj, ku për

pasojë miliarda euro mbetën pa menaxhim adekuat. Kur u emërua bordi para gati një viti, nuk u përfshi edhe anëtari nga sindikatat. Arsytet që u dhanë për këtë ishin se asnjëri nga aplikantët nuk i plotësonte

kushtet ligjore. Nga ajo kohë nuk është rishpallur konkursi", ka shkruar ish-kryeministri Hoti. Ai ka thënë se përgjegjës për këtë neglizhencë janë guvernatori i BQK-së, ministri i Financave dhe Auditorja e Përgjithshme. "Këta tre zyrtarë të lartë të shtetit, që përfaqësojnë shtyllat e institucioneve që menaxhojnë e mbikëqyrin çështjet ekonomike e financiare në Kosovë, e kanë neglizhuar obligimin e tyre ligjor që punëtorët të kenë përfaqësuesin e tyre në Bordin e që menaxhon kursimet e tyre pensionale. Kjo neglizhencë nuk ka si të mos jetë e qëllimshme. Gjatë gjithë mandatit të kësaj qeverie, sindikatat janë luftuar e janë neglizhuar. Ato nuk janë marrë parasysh në përgatitjen e

ligjit të pagave, e as të ligjit për zyrtarët publik. Të dyja këto ligje kanë përfunduar në Gjykatën Kushtetuese dhe është dashur të ndryshohen", ka thënë Hoti, duke shtuar se gjatë mandatit të kësaj qeverie, e cila veten e quan të majtë, ka rënë organizimi sindikal. "Kjo dëshmohet nga përgjysmimi i pagesave të anëtarësisë në sindikata, që ka ardhur nga presioni i qeverisë ndaj sindikatave në nivele të ndryshme të organizimit sindikal dhe në forma të ndryshme. Sindikatat sot kanë të drejtë të padisin shtetin dhe këta tre zyrtarë për shkelje të ligjit. Neglizhenca për zbatim të ligjit është shkelje e ligjit, dhe shkelja e ligjit është vepër penale", ka theksuar Hoti.

Besnik Tahiri: 75 për qind e pozitave janë me ushtrues detyre

PRISHTINË, 29 MAJ - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se Kosova në institucionet kryesore, Kuvend, Kryeministri dhe Presidencë, po udhëhiqet nga ushtrues detyre. Sipas tij, kjo rrezikon stabilitetin dhe profesionalizimin e administratës shtetërore.

"Ndryshimet e sjella në pozitave drejtuese në të gjitha nivelet rrezikojnë stabilitetin dhe profesionalizimin e administratës shtetërore. Ku është konkluzioni i raportit të BE-së. Kosova në institucionet kryesore, Kuvend, Kryeministri dhe Presidencë, po udhëhiqet

nga ushtrues detyre, ku llogaridhënia është shumë problematike. Kjo praktikë po legalizohet edhe me Ligjin e ri për Zyrtarët Publikë. Kjo do të ankimohej në Gjykatën Kushtetuese", ka theksuar Tahiri, duke shtuar se 75 për qind e pozitave janë me ushtrues detyre.



Historia misterioze e kërkimit të Zotit nga njeriu



Rindërtimi i mënyrës se si njerëzit e kanë imagjinuar Zotin me kalimin e kohës, mund të sjellë me vete shumë surpriza. Kjo sepse Perënditë u janë shfaqur njerëzve në një larmi të pafundme formash. Madje edhe Zoti ynë, ai i hebrenjve, të krishterëve dhe myslimanëve, duket se ka pasur identitete të ndryshme në kohët e lashta.

Zoti i kafshëve

Paraqitja e parë e një hyjnie në formë njeriu, por me brirë dreri dhe lëkurë ujku, është zbuluar në Shpellën e Tre vëllezërve në Francë, dhe daton rreth 25 mijë vjet më parë. Figura paraqet një shaman të hyjnizuar (një lloj prifti primitiv që ishte në kontakt me shpirtat).

Në kohët parahistorike, kur hynin në një gjendje ekstaze, shamanët pretendonin se depërtonin në botën e shpirtave. Ata ishin hyjnitë zoomorfike, pra me forma kafshësh, që konsideroheshin si Zota të specieve të gjuajtura (Zoti i Mamuthëve, Zoti i Kalit të Egër, Kau të Egër e kështu me radhë, siç janë ato të përshkruara në shpellën Lasho). Më vonë hyjnia mori tipare femërore në Epokën e Paleolitit dhe me lindjen e bujqësisë. Statujat e shenjta të Venusit me barkun, gjoksin dhe të pasmet e theksuara, përshkruanin hyjninë Nënë, mbrojtësen e pjellorisë.

Më në fund, me pushtimet e popujve luftarakë Kurgan që vinin nga fushat e Vollgës, dhe me përhapjen e luftës në Evropë, u shfaqën hyjnitë

mashkullore. Ishin Zotat e ushtrive, “flamujt” e popujve të ndryshëm. Nëse një popull fitonte mbi një tjetër, kjo donte të thoshte se Zoti i tyre ishte më superior.

Zoti i Biblës

Megjithatë, me Jahve-n, Perëndinë hebraike të Biblës, gjërat shkuan ndryshe. Edhe pse humbi, me popullin e tij në mërgim, ai konsiderohej krijuesi, i vetmi Zoti i vërtetë, i të gjithëve, dhe jo vetëm një mbrojtës i popullit të tij. Dhe ky imazh i ri i Zotit, u përhap falë mjetit të frikshëm teologjiko-popullarizues të Biblës.

Por u desh të kalonte shumë kohë, dhe sot dihet që ai ishte rrugëtim i gjatë. Duke analizuar Shkrimet e Shenjta me metodën historiko-kritike, studiuesit kanë zbuluar se monoteizmi u vendos në një mënyrë disi të ndryshme nga ajo që besohet zakonisht.

Edhe pse hebrenjtë konsiderohen si pionierë, sot hipotetizohet se origjina e tij e vërtetë është tek hyjnia egiptiane Aten, disku diellor (i quajtur edhe Amen, i njëjti term me të cilin përfundojnë sot

lutjet e të krishterëve dhe myslimanëve).

Kur në Egjipt u rivendos politeizmi, besimtarët e Aten, të mërguar më herët, e kishin eksportuar monoteizmin. Themeluesi i psikanalizës, Sigmund Frojd, spekuloi se Moisiu ishte në fakt njëri prej tyre. Por kalimi në monoteizëm nuk ishte i drejtpërdrejtë.

Një nga emrat biblikë të Zotit, Elohim, është një emër në shumës:shumësi i Eloah. Tek Zanafilla (1, 26) ai thotë: “Ta krijojmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë!”. Shpjegimi i zakonshëm, është se ishte një formë e shumësit mbretëror për të lartësuar figurën e Zotit.

Nuk do të kesh Perëndi të tjera...

Por sot është ngritur hipoteza, se është në fakt një gjurmë gjuhësore e një faze të mëparshme politeiste të fesë hebraike, e ndikuar nga kultet e tokës së Kananit, drejtuar perëndisë El. Eloah lexon “Allah”, term me të cilin myslimanët i drejtohen Zotit. Dhe nuk është e vetmja afërsi. Nuk duhet harruar se sipas Shkrimeve të Shenjta, Abrahami, profeti i besëlidhjes me Zotin, është paraardhësi i 3 feve të mëdha monoteiste, nëpërmjet djemve të tij, Isakut (linja hebreo-kristiane) dhe Ismaelit (linja arabo-muslimane).

Prandaj, ka të ngjarë që hebrenjtë të kenë pasur një formë të monolatrisë (pra një fazë në të cilën nderohej një Zot

i shquar, por duke pranuar se kishte të tjerë pranë tij), dhe madje edhe përpara epokës së politeizmit.

Nëse nuk do të ishte kështu, pse duhet të thuhet tek Dhjetë Urdhëresat: “Nuk do të keni perëndi të tjera para meje” (Eksodi 20:3)? Dhe pse duhet të këndonin izraelitët pas kalimit të Detit të Kuq “Kush është si ti midis perëndive, o Zot” (Eksodi 15:11)?

Gruaja e Zotit

Hyjnia e qytetit Ugarit, El (Elohim i përmendur në Bibël), kishte për grua Asherah-un, po edhe fëmijë. Nga këtu mund të burojë shprehja biblike “fëmijët e Zotit”. Në rrotullat e Detit të Vdekur, një koleksion tekstesh të shenjta që variojnë nga shekulli I deri në shekullin III Pas Krishtit, lexojmë një version më të vjetër të Ligjit të Përtërirë biblik, sesa ai i teksteve kanonike.

Aty shkruhet se çdo anëtar i familjes hyjnore merr nga El një komb, dhe Izraeli është kombi që i përket Jahves (Dt 32: 8-9). Fëmijët e Zotit thirren që të përulen përpara Zotit në Psalmin 29. Për më tepër, ka shumë pasazhe biblike në të cilat përmendet Zoti, megjithëse në një pozicion epërsie, brenda një panteoni ku ndodhen edhe Perëndi të tjera. Për shembull “Unë do të lëvdoj përpara Perëndive” (Psalmi 138, 1); “Zoti ynë është më i madh se të gjitha Perënditë e tjera”; “Perëndia është Zoti i zotave” etj. Nëse bijtë e El përfunduan

duke marrë një kuptim tjetër, Asherah, i njohur më mirë si Astarte, pati një fat më të keq.

Kulti i saj u çrrënjës, siç mund të lexohet tek Ligji i Përtërirë 12:3: “Do të shembni altarët e tyre, dhe do t’i fshini emrat e tyre në ato vende”. Megjithatë, kujtimi i Asherah u rikthye me zbulimin arkeologjik të pllakave të gurit me mbishkrimin: “Jahve dhe shoqja e tij Asherah”.

“Triniteti”, një koncept shumë i lashtë

Edhe kulti i Aten duhet të ketë përfshirë në çdo rast Izraelin. Sot studiuesit mendojnë se Aten u bë “Adonai”, një term tjetër që përdoret për të treguar Zotin në Bibël. Një rindërtim kritik i historisë supozon se mbreti Saul, i angazhuar ushtarakisht kundër filistinëve, vlerësoi se mesazhi i paqes i këtij Zoti egiptian, nuk ishte i përshtatshëm për një politikë pushtuese.

Për të ishin më mirë një Zot kombëtar “i ushtrive”.

Për këtë arsye, ai mbështeti kultin vendas të Jahve-s, pa e kundërshtuar kultin e mëparshëm, për të shmangur përçarjen. Kështu tek Zoti i Izraelit, u bashkuan dy ndjeshmëri fetare: ajo e Aten/Adonait dhe ajo e Jahve-s. Shumëllojshmëria e emrave me të cilët përmendet Zoti në Bibël (Elohim, Adonai, Jahveh) tregonte hyjnitë e ndryshme, të cilat u shkrinë në një në një proces të ngadaltë.

Marrë me shkurtime nga Focus – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ademi: Punimet në 'Fadil Vokrri' po kryhen në kohë rekorde

PRISHTINË, 29 MAJ - Rindërtimi i fushës së stadiumit "Fadil Vokrri" po kryhet në kohë rekorde, ka njoftuar presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, në "Instagram". "Punimet

në fushën e stadiumit 'Fadil Vokrri' po kryhen në kohë rekorde. Javën tjetër bëhet vendosja e barit hibrid", ka shkruar Ademi, teksa ka publikuar fotot e fundit nga fusha

e këtij stadiumi, ku shihet se është bërë vendosja e dheut në pjesën më të madhe të fushës, pasi është kryer procesi i drenazhimit dhe instalimit të sistemit të ujitjes dhe ngrohjes.

Sipas parashikimeve të punëmarrësit, fusha do të jetë gati për ndeshje më 6 korrik dhe në bazë të ritmit të punëve pritet që ajo të jetë e gatshme edhe më herët.



Ballkani zyrtarizon largimin e dyshes Kuç - Thaqi: Faleminderit legjenda

"Epoka e re"

SUHAREKË, 29 MAJ - Skuadra kampione e Kosovës, Ballkani, ka zyrtarizuar të mërkurën largimin e dy futbollistëve Edvin Kuç dhe Armend Thaqi. Klubi nga Suhareka ka vlerësuar lart kontributin e dyshes në fjalë për sukseset e jashtëzakonshme si në rrafshin vendor dhe në atë ndërkombëtar. Ballkani i ka quajtur legjenda Kuçin dhe Thaqin, ndërsa ka bërë me dije se dyert e klubit janë gjithmonë të hapura. "Kanë zbritur në fushë për qindra ndeshje! Në secilën prej tyre veç e veç. U paraqitën me motiv e përkushtim të jashtëzakonshëm, duke dhënë

shembullin tipik se si duhet sakrifikuar për skuadrën dhe fanellën që bartën. Atë e djersitën me vetëmohim në çdo minutë të betejave futbollistike, e jo rrallë edhe të gjakosur nuk u dorëzuan, duke vazhduar të luftojnë për qëllimet dhe objektivat e klubit. Ta kesh një kalibër të futbollistit të tillë për ta udhëhequr skuadrën do të thotë shumë, kurse ne ishim edhe më me fat, pasi dy liderë të tillë i kishim në fushë. Edvin Kuç dhe Armend Thaqi janë modeli që do t'u shërbejë gjeneratave, janë kulminacioni i profesionistëve sportivë, definicioni i vërtetë i titullit kapiten!", thuhet në postimin e Ballkanit. "Të gjitha sukseset tona historike janë të

lidhura ngushtë me kontributin e çmuar dhe të paharruar të dy yjeve tanë. Ata do të mbetën përjetësisht kapitenët unikë që, si të tillë, motivuan bashkëlojtarët e tyre edhe në momente prej më të vështirave, e prijës të tyre ishin edhe në rrugën drejt glorifikimit. Faleminderit legjenda të FC Ballkanit. Ky klub do të mbetet shtëpia juaj e përhershme, ku ju presim sërish!", thuhet në postimin e kampionit të trefishtë të Kosovës. Ballkani në edicionin e sapopërfunduar ishte pjesë në grupet e Ligës së Konferencës, derisa përveç që arriti të shpallet për herë të tretë radhazi kampion, doli edhe fitues i Kupës së Kosovës.



Bushi: Medon Berisha e la Kosovën për shiritin e kapitenit në Shqipëri

TIRANË, 29 MAJ - Medon Berisha, kosovari që la grupmoshat e Përfaqësueses së Kosovës për të kaluar në ato të Shqipërisë, ka marrë një ftesë nga Sylvinho për "Euro 2024", por tani trajneri i Shqipërisë U21 ka zbuluar mënyrën se si i kanë joshur futbollistët kosovarë për ta lënë Kosovën ndër vite, me theks të veçantë Berishën. Bushi në një konferencë për shtyp zbuloi se kishte kontaktuar Medon Berishën sa ai ishte pjesë e Kosovës dhe i kishte ofruar shiritin e kapitenit për të ardhur në Shqipëri. "Simoni dhe Berisha kanë qenë pjesë e ekipit A. Simoni



ka qenë në stërvitje, për Medon Berishën është hera e parë. Kemi pasur bindje për Berishën që do të ishte shumë herë në ekipin e parë, por ai vajti më herët seç menduam faktikisht. Për ne ka qenë lojtar deciziv, lojtar me personalitet, është ftesa e merituar plotësisht që Berisha ndodhet aty. Mbaj mend herën e parë kur e kam kontaktuar. Ai ishte pjesë e Kosovës dhe i premtova edhe shiritin e kapitenit që të ishte pjesë e Shqipërisë. Ia premtova sepse e shihja që kishte shumë personalitet në fushën e lojës. Ishte një lider dhe e meritoi plotësisht. I uroi shumë fat dhe

shpresoq që ta kemi në ndeshjen me Malin e Zi", ka thënë Bushi. Medon Berisha, që po luan në Serinë A te Lecce, është nga Kosova, por që fillimisht e kishte filluar me Shqipërinë U19 dhe U20, për të kaluar te Kosova U21 në qershor të vitit 2022, por papritmas vetëm disa muaj një zgjedhje që u tha se buroi nga zemra, ndryshoi dhe tashmë është mësuar që ai la Kosovën për shiritin e kapitenit të premtuar nga trajneri Bushi. 20-vjeçari ka bërë gjashtë paraqitje në këtë sezon të Serie A-së, teksa u paraqit edhe një herë në Kupë të Italisë.

Rrahmani në formacionin e sezonit në Rumani

BUKURESHIT, 29 MAJ - Albion Rrahmani ka pasur një super sezon me skuadrën e tij të Rapid Bucurestit. Në 30 paraqitjet e edicionit në Superligën e Rumanisë, Rrahmani ka shënuar 19 gola në të gjitha garat. Këto

paraqitje tejet të mira të tij, kanë bërë që sulmuesi nga Kosova të zë vend në formacionin e sezonit në Rumani. Albioni një kohë i mungoi Rapidit për shkak të lëndimit, por u kthye fuqishëm, duke marrë zemrat e tifozëve me

golat e tij. Përveç 19 golave, Rrahmani ka kontribuar edhe me pesë asistime. Ai është futbollisti më i kërkuar në treg. Për të interesim ka nga disa top skuadra evropiane, si nga kampionati anglez, italian e ai

gjerman. Në Angli më e interesuara është Aston Villa, në Itali ekipi i Napolit, ndërsa në gjermani Werder Bremeni. Vlera e 23-vjeçarit, sipas sajtit "Transfermarkt", është 2.3 milionë euro.



Flick paraqitet te Barcelona

BARCELONË, 29 MAJ - Trajneri Hansi Flick është emëruar trajner i ri i Barcelonës. Lajmi është dhënë nga klubi katalanas në rrjetet sociale. Tekniku gjerman do ta nisë menjëherë punën në klubin

spanjoll, ku do të pasojë Xavi Hernandezin. Ai ka nënshkruar një kontratë, të vlefshme deri në vitin 2026. Barça synon të rikthehet mes skuadrave protagoniste jo vetëm në La Liga, por edhe në

Ligën e Kampionëve. Drejtuesit dhe trajneri i ri shumë shpejt do të takohen për të vendosur për planet e merkatos. "FC Barcelona dhe Hansi Flick kanë arritur një marrëveshje që gjermani të

bëhet trajner i ekipit deri më 30 qershor 2026. Flick ka nënshkruar një kontratë në zyrat e Klubit, i shoqëruar nga presidenti Joan Laporta", thuhet në njoftimin e Barcelonës.



Verstappen: Unë jam besnik i kontratës, kërkoj që edhe Red Bulli të jetë kështu

SHTUTTGART, 29 MAJ - Javët e fundit Red Bulli duket se ka humbur shkëlqimin e dikurshëm, me McLaren e Ferrari që kanë fituar nga një garë në tri të fundit. Ndaj në këtë moment, më shumë se kurrë, brenda ekipit është e nevojshme të mendohet për performancën në pistë, pa u shpërqendruar nga politika që silllet rreth ekipit. Gjatë një interviste me "The Guardian", pas garës së Montekarlo, piloti holandez Max Verstappen e bëri të qartë se kishte pasur mjaft thashetheme për të ardhmen e tij: "Sa më shumë që flas për të, aq më shumë njerëz duan të shkruajnë. Njerëzit marrin disa pjesë të saj dhe bëhet një rrëmujë e madhe". "Unë flas dhe më pas ka përkthime në spanjisht, holandisht ose në ndonjë gjuhë tjetër. Të flas për të ardhmen time nuk do ta ndihmojë situatën. Do të preferoja që të mos ishin të gjitha këto histori. Janë gjëra që ndodhin brenda ekipit me të cilat duhet të përballemi dhe të ecim përpara", ka thënë piloti holandez. "Unë kam një kontratë me ekipin për të bërë punën time, për të siguruar një nivel të lartë të



performancës dhe kjo është ajo ku jam i fokusuar. Unë nuk jam politikan dhe nuk më pëlqen politika. Unë flas për performancat e mia me njerëzit rreth meje, duke u përpjekur ta shpërqendroj veten nga gjërat negative", tha Verstappen. Jos Verstappen, babai i Max, u rikthye në garazh këtë fundjavë në Montekarlo. "Babai im do të qëndrojë gjithmonë me mua. Ai dhe Horner nuk janë në konflikt. Njerëzit mund të kenë mendime të ndryshme, por kjo është një histori tjetër. Kur u transferova në Red

Bull, Christian ishte një shtyllë në këtë vendim", ka deklaruar 3 herë kampioni i botës në Formula 1. Verstappeni rithekson besnikërinë ndaj Red Bullit, me të cilin ka kontratë deri në vitin 2028: "Unë jam një person besnik dhe kjo do të thotë shumë për mua. Kjo është ajo që i kërkoj skuadrës dhe deri më tani kjo ka qenë gjithmonë fantastike dhe dua të qëndrojë kështu për një kohë të gjatë. Do të ishte fantastike të përfundosh në Red Bull. Ta kalosh një karrierë të tërë në një ekip do të ishte e pabesueshme".

Minnesota mposhti Dallasin dhe rihapi garën në Perëndim

SAINT PAUL, 29 MAJ - Rihapet disi gara për shpalljen e ekipit kampion në Konferencën e Perëndimit në NBA. Minnesota fitoi me rezultat 105-100 ndaj Dallasit në finalen e katërt "play-off", duke rihapur garën për titull. Skuadra teksane tashmë udhëheq 3-1 serinë e finaleve dhe është vetëm një fitore larg shpalljes kampion. Dallasin nuk arriti të shfrytëzojë këtë herë faktorin fushë, duke u dorëzuar në fund para publikut të tij. Të gjithë titullarët e Minnesotas realizuan mbi 10 pikë, duke bërë dallimin në fushë. Më i miri për miqtë ishte Edwardsi me 29 pikë e 10 rebounde, mbështetur nga Townsi me 25 pikë. Për teksanët, Luka Donçiq realizoi një "triple double", me 28 pikë, 15 rebounde e 10 asistime, por që nuk



mjaftuan. Ndeshja e radhës do të luhet në fushën e Minnesotas, që do të kërkojë ta mbajë gjallë shpresën, ndërsa Dallasin ta mbyllë garën. Në Konferencën e Lindjes,

ekipi i Boston Celticsit ka siguruar një biletë për në finalen e titullit në NBA dhe pret fituesin e çiftit nga Lindja, me sfidën e parë që do të luhet më 6 qershor në Boston.

SHKURT

Atalanta ofron 28 milionë euro për Asllanin, Interi e refuzon

Atalanta zhvilloi një sezon fantastik duke fituar Evropë Ligën, ndërkohë që dështoi të fitojë Kupën në finalen ndaj Juventusit. Në shtëpinë e bergamaskëve kanë nisur të bëjnë llogari për sezonin e ri. Sipas medieve italiane, Gasperini kërkon në skuadër një regjisor të ri, për këtë rol u ka sugjeruar drejtuesve të klubit emrin e Kristjan Asllanit. Ky nuk është thjesht një dëshirë, apo një thashetheme, por një projekt konkret mbi të cilin drejtuesit e Atalantas u vunë menjëherë në lëvizje. Gjithnjë sipas medieve, Atalanta ka paraqitur ofertën e parë zyrtare, 28 milionë euro për kartonin e Asllanit, por kjo ofertë me sa duket është refuzuar në mënyrë të prerë nga drejtuesit e Interit. Pavarësisht se Asllani është aktivizuar pak edhe këtë sezon, ylli kuqezi shihet nga Marotta dhe Ausilio si një lojtar i paprekshëm, duke vlerësuar shumë aftësitë e tij. Kujtojmë që Asllani ka kontratë me Interin deri në 2027.

Fabregas e dëshiron Manajn te Como

Rei Manaj do t'i japë lamtumirën Sivasporit gjatë kësaj vere por, me sa duket, edhe futbollit turk. Ofertat për lojtarin nuk kanë munguar, siç kanë shpjeguar edhe vetë drejtuesit e këtij klubi, ndërsa së fundmi ka dalë në skenë një e tillë shumë interesante. "Aksam" bën me dije se emri i Manajt ka përfunduar në radarët e klubit të sapongjitur në Serinë A, Como. Klubi i cili ka pronarë dy emra shumë të njohur të futbollit botëror si Cesc Fabregas dhe Tierrri Henri, kërkon të ndërtojë një ekip konkurrues në Itali për edicionin e parë në elitë ku synon mbijetesën, teksa sheh pikërisht Manajn si një lojtar që mund ta ndihmojë për këtë objektiv. Raportohet se Manaj është gati të bëjë prapakthehu në Itali, ku ka luajtur në kampionatin e elitës me fanellën e Peskarës dhe Specias, pa harruar këtu edhe përvojën e shkurtër me atë të Interit. Ai ka shprehur gjithmonë dëshirën për t'u kthyer në Itali dhe dy legjendat e futbollit botëror duken të gatshme për t'ia plotësuar atë.

Arteta paralajmëron rivalët: Duam të fitojmë trofe

I shpërblyer në "Globesoccer Awards" si trajneri më i mirë në Premierë Ligë, trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, foli nga skena për këtë çmim: "Jam jashtëzakonisht krenar, sepse kur vendosa ta ndaloj karrierën time si lojtar mendoja se gëzimet e futbollit do të zhdrukeshin". "Sapo fillova karrierën time si trajner, përjetova emocione të tjera, më të mira. Ndiej një pasion të madh për atë që bëj dhe duhet t'i falënderoj të gjithë lojtarët dhe stafin që më mbështesin në këtë rrugëtim që shpresoj të na çojë në majë dhe të fitojmë një trofe", ka shtuar Arteta. Prej dy sezonesh, "topçinjtë" renditen në vendin e dytë në Premierë Ligë, ndaj të gjithë presin që më në fund Arsenali të fitojë diçka. "Fitore, fitore dhe fitore në të ardhmen. Ne kemi një ekip plot entuziazëm dhe duam të fitojmë trofe. E dimë që duam ta bëjmë, se konkurrenca është e fortë, por do të bëjmë më të mirën", ka pohuar Arteta.

Hummelsi për lënien jashtë 'Euro 2024': Jam një nga mbrojtësit më të mirë në Gjermani

Mbrojtësi i Borussia Dortmundit, Mats Hummels, ka reaguar më në fund lidhur me vendimin për ta lënë jashtë skuadrën së Kombëtares së Gjermanisë për "Euro 2024". "Unë mund të kuptoj që një grup

është rritur së bashku që nga marsi. Për mua si individ është e hidhur sepse aktualisht jam një nga pesë mbrojtësit më të mirë në Gjermani. E kam atë vetëbesim. Nëse do ta kisha këtë në mars, mund të kisha qenë atje

atëherë dhe tani gjithashtu pjesë e skuadrës së Euros", ka thënë Hummels. Ekziston një besim se Hummels nuk do të lulëzonte si lojtar zëvendësues për shkak të shqetësimeve rreth trazirave të mundshme. Por, ylli i

Dortmundit e ka mohuar këtë. "I thashë Nagelsmannit: 'Unë do të ulem në stol dhe mund të jem gjithashtu qendërmbrojtësi i pestë' - do ta kisha bërë këtë. Ai e dinte qëndrimin tim. Doja që ai ta dinte këtë. Por, nëse e kuptova

saktë, ai shqetësohej edhe për gjëra të tjera përveç pranimit të një roli zëvendësues. Siç e kuptova, ishte më tepër për gjëra të lidhura me moshën dhe formën", ka përfunduar ylli i Dortmundit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT


SWISS TAVERNA


Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lumë's Details

 lumescdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ermira Emini shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1 deri 7 të shkollës fillore "Eqrem Çabej.
- Ermira Emini shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 8 deri 9 të shkollës fillore "Aziz Sylejmani".
- Violeta Shaqiri shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Xheladin Deda".
- Esat Ama nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Ideal Hana nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Sara Hana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Anisa Azemi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e SH.M.M. "Prenk Jakova" Prishtinë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Ermira Emini shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 1 deri 7 të shkollës fillore "Eqrem Çabej. rin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L



TRADITË QË NGA

1992

